



Sugjerime dhe truke për temën...

# Lavdërim dhe vlerësim

Të gjithë njerëzit, qoftë të rriturit ose fëmijët, kanë nevojë për vlerësim.

# Lavdërim dhe vlerësim

**Të gjithë njerëzit, qoftë të rriturit ose fëmijët, kanë nevojë për vlerësim.** Me lavdërimin dhe vlerësimin fëmija ndihet i perceptuar dhe i konfirmuar. Ky e forcon dhe motivon fëmijën tuaj.

## **Ju mund të bëni këtë:**

- Vëzhgoni fëmijën tuaj, merrni parasysh sjelljen e tij të mirë dhe lavdëroni atë!
- Lavdërimi juaj duhet të jetë gjithmonë shumë konkret, pozitiv dhe i sigurtë; p.sh. «Ti ke vënë gjithçka në rregull të mirë, të lumtë!»
- Mos e teproni lavdërimin.
- Mos lavdëroni fëmijën vetëm për rezultatin, por edhe kur ai mundohet.
- Lavdërim dhe vlerësim tregoni me fjalët tuaja, me një buzëqeshje, një vështrim, një prekje, një mimikë ose një gjest.

## **Meqë ra fjala:**

Fëmijë që lavdërohen shpesh janë shumë më shumë kooperative; d.m.th. ata tregojnë gatishmëri që të merren me të tjerë.

## **Früherziehungsdienst des Kantons Bern FED**

Geschäftsstelle, Frankenstrasse 1, 3018 Bern

Telefon 031 869 18 78, [info@fed-be.ch](mailto:info@fed-be.ch), [www.fed-be.ch](http://www.fed-be.ch)